

## MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLTË

midis

Kolegjit 'UNIVERSUM'- Prishtinë

Dhe

SBASHK (Sindikata e Bashkuar e Arsimit Shkencës e Kosovës)- Prishtinë

### I. Qëllimi i Memorandumit

1. Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit palët nënshkruese kanë shprehur vullnetin dhe gatishmërinë për bashkëpunim dhe njohje të ndërsjellët, duke synuar ngritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive profesionale dhe akademike dhe ndërlidhjen e mësimit akademik me punë praktike dhe anasjelltas.

### II. Fushëveprimtaria

1. Me anë të këtij memorandumi, Kolegji Universum merr përsipër ofrimin e bursave të pjesërishtme akademike për anëtarët e SBASHK-ut dhe familjaret e tyre.
2. Bursat ofrohen 30% për nivelin Baçelor për tri vite studimi dhe nivelin Master për dy vite studimi. Ata të cilët kanë përfunduar baçelor sistemin tre vjeçar atëherë studimet master zgjasin dy vite, ndërsa nëse kanë përfunduar studimet baçelor sistemin katër vjeçar atëherë studimet master zgjasin një vit.

Shuma e paraparë mund të paguhet deri me 12 këste.

3. Me anë të këtij memorandum mirëkuptimi SBASHK dhe Kolegji Universum do të bashkëpunojnë në aplikime për grante nga organizatat ndërkombëtare siq janë USAID, UNDP, Komisioni Evropian etj.
4. Me anë të këtij memorandumi të mirëkuptimit, palët dakordohen që të bëjnë shkëmbimin e stafit **(në raste të caktuara)** për pjesëmarrje në ligjërata publike apo evenimente të organizuara në frymën profesionale.

### III. Përzgjedhja e Kandidatëve për Bursa

Përzgjedhja e përfituesve të bursave do të bëhet nga SBASHK duke respektuar kriteret e përgjithshme. Përvoja paraprake dhe mundësia e kandidatëve për tu ngritur në karrierë duhet të merren parasysh gjatë procesit të përzgjedhjes. Preferohet që përzgjedhja e kandidatëve të mos koncentrohet në një departament apo nivel të menaxhmentit. Preferohet që të ketë diversitet (gjinor, etnik, fetar dhe social) gjatë përzgjedhjes së kandidatëve. Kandidatet e përzgjedhur duhet të posedojnë kontratën e punës valide me institucione arsimore ose në rast se është familjar autorizim nga personi i punësuar në Institucione arsimore si dhe kopjen e kontrates me Institucionin arsimor.

### V. Përdorimi i informatave dhe dokumentacioni

I. Palët pajtohen që çdo informacion, dokument apo të dhëna, të shkëmbyera apo të pranuar sipas këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, do të përdoren vetëm për qëllime të lejuara dhe brenda përkufizimeve të përcaktuara me këtë dokument. Palët nuk do të shpërndajnë apo bëjnë publike asnjë informacion, dokument apo të dhëna ndonjëherë palë për qëllime tjera, jashtë përkufizimeve të përcaktuara me këtë Memorandum apo që mund të bien ndesh me frymën e këtij, pa aprovim paraprak të palës tjetër;

II. Palët do të përdorin dhe trajtojnë çdo informacion, dokument apo të dhëna si komunikim të ndërsjellët me besueshmëri të plotë;

VI. Çdo mosmarrëveshje, keqkuptim në realizimin e këtij Memorandumi, do të zgjidhet në frymën e tolerancës, mirëkuptimit dhe në bazë të suazave të kodit moral.



VII. Ky Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit, përpos nëse parashihet ndryshe me marrëveshje nga ana e palëve të përfshira në memorandum.

### PALET NËNSHKRUESE

Prishtinë, më 29/Tetor/2014



Alejtin Berisha

Drejtor Ekzekutiv  
Kolegji Universum



Rrahman Jasharaj

Kryetar i SBASHK



Memorandum Mirëkuptimi

SBASHK - Struktura e Qendrës së Arsimt  
e Shkencës, Kulturës së Kosovës  
MESCK - The Union of Education, Science  
and Culture of Kosovo

№. 681/1  
Data 29.10.2014